



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e63-të, të mbajtur më 15.03.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-7042/1 e datës 13.12.2021, e dorëzuar në KSHPK nga parashtruesi i njohur, kundër institucioneve shtetërore në RMV-së, **REFUZOHE**T.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit, sepse pretendimet në fjalë kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtës individuale dhe për çështje që nuk i nënshtrohen veprimit të saj kompetent dhe të cilat është vepruar nga autoritetet e tjera kompetente.

Lënda me numër 12 -7042 të datës 13.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 13.12.2021, është bërë denoncim me numër 12-7042/1 të datës 13.12.2021 kundër institucioneve shtetërore në RMV-së për papërgjegjshmëri dhe masa të ndërmarra formalisht prej tyre, konkretisht nga MPB, Prokuroria Publike dhe Gjyqësori.

Rasti ka të bëjë me një kallëzimin penal të ngritur nga SPB Tetovë, e cila vepron pas ngjarjes së denoncuar nga parashtruesi më datë 21.01.2020, ndaj një personi fizik nga Tetova për shkak të ekzistimit të shkaqeve të dyshimit për vepër penale "keqpërdorimi i të dhënave personale". "rrezikim" "siguri" dhe "shtrëngim", për shkak se ka hapur një profil të rremë në rrjetin social të një përdoruesi në emër të një gruaje të moshuar dhe ka përpunuar e postuar fotografi të viktimës, si dhe ka dërguar foto dhe tekste me përmbajtje vulgare dhe të papërshtatshme në adresë të viktimës, bashkëshortit dhe familjarëve të saj, si dhe e detyroi viktimën të kryente marrëdhënie seksuale në disa raste dhe e filmonte atë kundër dëshirës së saj. (e dëmtuara është bashkëshortja e parashtruesit, e cila ka qenë e punësuar në MPB)

Për veprimin e Prokurorisë Publike Tetovë, e cila me datë 03.06.2020 ka marrë aktvendim për refuzimin e kallëzimit penal për veprën penale "rrezikimi i sigurisë" dhe "shtrëngimi", për shkak se veprat e raportuara nuk janë vepra penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, janë bashkangjitur provat dhe lidhur me veprën penale "keqpërdorimi i të dhënave personale" ka paraqitur propozim për dhënien e urdhrit penal ndaj të raportuarit.

Gjykata Themelore në Tetovë, duke vepruar në rastin penal, me propozimin për dhënien e urdhrit penal të Prokurorisë Publike Tetovë, ka marrë aktgjykim të datës 16.06.2020 me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor dhe është dënuar me gjobë prej gjithsej prej 250 euro.

Për rastin është njoftuar edhe Avokati i Popullit, i cili ka iniciuar procedurë dhe ka kërkuar informacion nga MPB-ja, SPB Tetovë dhe për këtë e ka njoftuar parashtruesin më 13.10.2020. Njëkohësisht, më 24.11.2020, Avokatit të Popullit i është dorëzuar njoftim për pezullim të procedurës për shkak të mungesës së bazës për veprime të metutjeshme të tij.

Parashtruesi, si punonjës i Ministrisë së Brendshme, ka paraqitur ankesë për rastin në Sektorin e Kontrollit të Brendshëm dhe Standardeve Profesionale, për të cilën është vepruar dhe ka marrë përgjigje nga data 10.11.2020 se janë kryer kontrole dhe mbikëqyrje të dokumentacionit, pas së cilës është konstatuar se nuk janë vërtetuar pretendimet e bëra në denoncim, por janë konstatuar lëshime të tjera të punonjësve të policisë, për të cilat ndaj tyre janë marrë masat përkatëse.

Parashtruesi nuk është i kënaqur me veprimet dhe vendimet e të gjitha institucioneve të llastuara më lart, të cilave u është drejtuar dhe të cilat kanë vepruar në rastin në fjalë, prandaj i drejtohet edhe KSHPK-së.

Gjatë shqyrtimit të rastit, KSHPK-ja ka konstatuar se në këtë rast ka qenë shkelje e së drejtës individuale/personale të një personi të afërt të parashtruesit të denoncimit, gjë që është vepruar nga organet tjera kompetente dhe procedura është zhvilluar pranë organeve kompetente gjyqësore dhe prokuroriale dhe konstatoi se ka qenë për pretendime për çështje që nuk i nënshtrohen veprimit kompetent të saj. Prandaj, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndë dhe vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KOMISIONI SHITETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te
Parashtruesi i denoncimit
Punoi: J.C.
Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së